



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	29-05-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSJKX	4508/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.641/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.666/2023 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ nga _____ kundër organit të punësimit Komunës së Fushë Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.666/2023 e datës 18.04.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ (*tutje ankuesi*) i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës, më datë 18.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtatë (7) në koeficientin nëntë pikë pesë (9.5), prej datës 01.07.2016, kompensimin për periudhën 2010-2014 si dhe rregullimin e gradës për periudhën e ardhshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Fushë Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 10.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3614/2023 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër 35 të datës 17.01.2023 të parashtruar nga ankuesi tek Drejtoria e Administratës në Komunën e Fushë Kosovës; Përgjigjen në kërkesën të ankuesit përmes e-mailit të datës 15.02.2023; Akt emërimi me nr.926 të datës 26.07.2016 të ankuesit; Vendimi me nr.455 të datës 29.10.2001 për pozitën bashkëpunëtor informativ; Aktvendim me nr.303 të datës 04.06.2003; Kontrata e punës me nr.76 e datës 04.06.2006; Kontrata e punës e datës 02.06.2006; Kontrata e punës me nr.037/07 e datës 02.06.2007; Kontrata e punës me nr.045/10 e datës 01.04.2010; Akt emërimi i datës 01.06.2011; Kërkesën për përgjigje e datës 24.04.2023; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit e datës 10.05.2023 dhe Kontrata e punës me nr.059/09 e datës 01.06.2009.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Fushë Kosovës dhe se i njëjti nga data 29.10.2001 deri me 03.06.2003 ka ushtruar pozitën e punës Bashkëpunëtor Informativ, nga data 04.06.2003 deri me datë 01.06.2007, ka ushtruar detyrën e Bashkëpunëtorit Profesionale për Kulturë, nga data 02.06.2007 deri 31.03.2010 ka ushtruar detyrën e Zyrtarit për Informim, nga data 01.04.2010 deri me 01.06.2011 ka ushtruar pozitën Shef i Shtëpisë së Kulturës/Zyrtar për Informim, nga data 01.06.2011 deri me 30.06.2016 ka ushtruar pozitën Shef i Shtëpisë së Kulturës, ndërsa nga data 01.07.2016 është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës së Udhëheqësit të Sektorit për Kulturë, Sport dhe Rini.

Ankuesi me datë 17.01.2023 ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtatë (7) në koeficientin nëntë pikë pesë (9.5), prej datës 01.07.2016, kompensimin për periudhën 2010-2014 si dhe rregullimin e gradës për periudhën e ardhshme. Drejtoria e Administratës përmes e-mailit të datës 15.02.2023 ka njoftuar ankuesin se kërkesa e ankuesit është dorëzuar tek organi jo kompetent, sepse që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtarët Publik në vitin 2019, nëpunësi civil i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejtë në Këshill, ndërsa lidhur me pagat Komuna e Fushë Kosovës ka përcjell pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve publike të gjitha dokumentet e kërkuara.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti njihet e drejta për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtatë (7) në koeficientin nëntë pikë pesë (9.5) prej datës 01.07.2016, kompensimin për periudhën 2010-2014 (nuk është specifikuar se diferenca e kompensimit) si dhe rregullimin e gradës për periudhën e ardhshme sipas Ligjit Nr.05/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi ka nënshkruar pa asnjë vërejtje Kontratën e punës të datës 01.04.2010 për pozitën e punës Shef i Shtëpisë së Kulturës/Zyrtar për Informim, Aktin e Emërimit me numër protokollit 314 të datës 12.04.2012 për pozitën e punës Shef



i Shtëpisë së Kulturës si dhe Aktin e Emërimit me numër protokolli 926 të datës 26.07.2016 për pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Sport dhe Rini dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me titullin e vendit të punës deri me datë 18.04.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi është emëruar Shef i Shtëpisë së Kulturës dhe Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Sport dhe Rini), përkatësisht nenin 130 pika 1 të këtij ligji ku përcaktohet se: "Ankimimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.",", andaj, mbi këtë bazë rrjedh së ankesa e ankuesit lidhur me pretendimet ankimore për kompensimi në mënyrë retroaktive është palejueshme.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për rregullim të koeficientit sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e këtij ligji i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizim i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Fushë Kosovës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës se tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.641 /2023

Sabile Haxhnikaj

Sabile Haxhnikaj
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

